

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,


Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 38 të Ligjit Nr. 03/L-189, për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6), të Rregullores Nr. 02/2011, për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), duke pasur parasysh Vendimin e Qeverisë Nr. 02/78 dt.09.03.2016 për ndryshimin e qëllimit të përdorimit të kompleksit banesor-afarist “Hade dhe Hade 2”, dhe vendimit nr.09/41 i dt. 07.04.2017 për plotësimi dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 02/78 dt.09.03.2016, nxjerr:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim, për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta nga këto kategori.
2. Komisioni sipas pikës një (1) të këtij vendim përbëhet prej pese (5) anëtarëve:
 - 2.1. Shqipe Krasniqi, u.d e Drejtorit të DFIDL/MPMS, Kryesuese e komisionit;
 - 2.2. Arif Krasniqi, Kryetar i SHIL të UÇK/Obiliq, anëtarë;
 - 2.3. Burim Gërguri, Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencia /KK-Obiliq, anëtar;
 - 2.4. Kaltrina Drançolli, Zyrtare e Lartë për politikat e banimit /MMPH, anëtare;
 - 2.5. Valentina Demolli, përfaqësuese e KMDLNJ-së, anëtare.
3. Në komision, pjesëmarrës do të jetë edhe një përfaqësues në cilësinë e vëzhguesit nga shoqëria civile.
4. E drejta në banim për përfituesit nga kjo kategori bëhet në Kompleksin kolektiv banesor-afarist “Hade dhe Hade 2”, Komuna e Obiliqit.
5. Në kompleksin kolektiv, pesëdhjetë (50 %) të njësive banesore destinohen për qëllimin e zgjidhjes së banimit të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta nga këto kategori.

6. Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave të tjerë me nevoja të veçanta nga këto kategori, vendose në bazë të procedurave të parapara me Ligjin Nr.03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta për banim, Udhëzimit Administrativ Nr.23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr.24/2010 për normat minimale të banimit për banesat nga programet e veçanta të banimit të nxjerra në bazë të këtij Ligji si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.14/2014 për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për sigurimin e banimit familjar për familjet e dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, për Veteranët e UÇK-së, invalidët civil të luftës, viktimat seksuale të luftës dhe familjarëve të tyre.
7. Komisioni në takimin e parë do të vendos për metodologjinë e punës për të gjithë procesin e përzgjedhjes për përfituesit e të drejtës në banim.
8. Komisioni, vlerësimin e gjendjes së banimit në teren, të familjeve si dhe verifikimin e të dhënave të kërkuarve e bënë në afat prej tridhjetë (30) ditësh.
9. Pas vlerësimit të gjendjes së banimit nga terreni i familjeve nga ana e Komisioni, Komuna publikon listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.
10. Mandati i Komisionit zgjat deri në dhënien në shfrytëzim të njësisve banesore për përfituesit të së drejtës në banim sipas pikës pesë (5) të këtij vendimi.
11. Komisioni për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
12. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Izedin Bytyqi


Sekretar i Përgjithshëm i MPMS-së

Vendimi i dërgohet:

- Anëtareve të Komisionit
- Zyrës së Ministrit
- Arkivit të MPMS